

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**  
**VENDIM**

**Nr. 54, datë 31.03.2026**

**PËR**  
**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT**  
**“EUROSIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe rregullores nr. 138, datë 21.12.2015 “Për miratimin ose refuzimin e ndryshimeve thelbësore të statutit të shoqërisë së sigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e ndryshimeve në statutin e shoqërisë së sigurimit Euros sig sh.a., me përmbajtje si vijon:**  
**“Neni 16, pika 16.2**  
16.2 Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, të cilët emërohen për një afat 3-vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Anëtarët e Këshillit emërohen nga mbledhja e përgjithshme e Aksionarëve, vetëm nëse Aksionarët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, vendosin me  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) e Aksionarëve që marrin pjesë në votim, sipas neneve 144, pika 1 dhe 145, pika 1, të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.  
**“Neni 18, pika 18.4**  
18.4 Mandati i administratorit të shoqërisë është 3 (tre) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.”
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**

**Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Adela XHEMALI**